



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË  
REKTORATI

Nr. 771/1 Prot.

Vlorë më, 19.03.2026

VENDIM

Nr. 04, datë 19.03.2026

PËR

MIRATIMIN PARAPRAK DHE PËRCJELLJEN PËR MIRATIM PËRFUNDIMTAR  
NË BORDIN E ADMINISTRIMIT, TË BOTIMIT TË MONOGRAFIVE NGA  
PERSONELI AKADEMIK I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORË

Në mbështetje të nenit 40 të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", neni 6, pika 4, dhe neni 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; neni 64 të Rregullores së Brendshme të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kërkimit Shkencorë dhe Projekteve me nr. 103/1 prot., datë 17.02.2026, Rektorati në mbledhjen e tij të datës 19.03.2026,

VENDOSI:

1. Të miratojë paraprakisht botimin si botim i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të monografisë "**Kodi i fjalës i përkthyer**", me autore **Prof. Asoc. Ilda Knanai**, të propozuar nga njësia bazë dhe të verifikuar nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.
2. Të miratojë paraprakisht botimin si botim i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të monografisë "**Gjuha dhe identiteti i shqiptarëve në integrimin evropian**", me autore **Dr. Bukuroshe Isufaj**, të propozuar nga njësia bazë dhe të verifikuar nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.
3. Të miratojë paraprakisht botimin si botim i Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë të monografisë "**Veçori gjuhësorë të ligjërimit femëror në politikë**", me autore **Dr. Anila Hima**, të propozuar nga njësia bazë dhe të verifikuar nga Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.
4. Monografitë e sipërpërmendura, pas këtij miratimi paraprak nga Rektorati, t'i përcillen Bordit të Administrimit të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë për miratim përfundimtar, në përputhje me nenin 64 të Rregullores së Brendshme të Universitetit.
5. Pas miratimit përfundimtar nga Bordi i Administrimit, autorët përkatës lidhin kontratë dypalëshe me Administratorin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE**  
**REKTORATI**

përputhje me pikën 3 të nenit 64 të Rregullores së Brendshme të Universitetit, ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, si dhe masa dhe mënyra e pagesës së autorit.

6. Përpara dërgimit për botim, materialet t'i nënshtrohen verifikimit në sistemet antiplagjiaturë dhe të pajisen me citimet përkatëse për autorësinë dhe të drejtat e autorit, në përputhje me pikën 5 të nenit 64 të Rregullores së Brendshme të Universitetit.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**REKTORE**

**PROF. DR. AURELA SALIAJ**

